



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT

Nr. 35/1 Prot.

RHK  
Kopje nr. 2  
Tiranë, më 19 .09.2018

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 652, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr.13, datë 03. 05. 2018, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë “deklasifikimin e plotë” të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 15 , datë 19 .09.2018 si më poshtë:

**FONDI ARKIVOR I ISH SIGURIMIT TË SHTETIT QË ADMINISTRUOHET NGA AIDSSH**

1. Dosje përpunimi nr. 567, në ngarkim të **F. Shkreli**, kategoria 2 A. Dosja ka një volum me 61(gjashtëdhjet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes ishte “sekret”. Dosja i përket Fondit të Zbulimit (Drejtoria e II-të).
2. Dosje formulare nr. 915-A, në ngarkim të **H. Spahiu**, kategoria 2 B. Dosja ka një volum 170 (njëqind e shtatëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes ishte “tepër sekret”. Dosja i përket ish Degës së Punëve të Brendshme Lushnje (Operative).
3. Dosje formulare nr. 211-A, në ngarkim të **J. Kazazi**, kategoria 2 B. Dosja ka një volum me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) dokumente. Niveli i klasifikimit të dosjes ishte “tepër sekret”. Dosja i përket ish Drejtorisë së Zbulimit Politik (Operative).

KRYETARI I KDZH

